

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-0692*****Në ankesën e******Paditësja/Ankuesja*****F Zh**, Prishtinë - e përfaqësuar nga avokat M M, Prishtinë.**kundër*****E paditura*****NSH. "Marketing Export"**, (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj, dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2710 të datës 23 nëntor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 04 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditëses është e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2710 të datës 23 nëntor 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me 11 prill 2014, paditësja e dorëzoi në DHPGJS- një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN096-0159, të datës 26 mars 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditëses e datës 10 shkurt 2014 për pagesën e pagave të pa paguara për periudhën prill 2003-dhjetor 2011 në shumë të pa përcaktuar, nga NSH "Marketing Export" në Prishtinë, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së bashkuar. Paditësja në ankesë pohon se gjatë kësaj periudhe nuk ka mundur të ushtroj punën së bashku me kolegë e punës për arsye se objekti ishte marr nga Ombudspersoni, anadaj edhe ka qenë e detyruar që të mos e ushtroj profesionin e saj. I ka propozuar DHPGJS që ata aprovoj ankesën e saj si të bazuar. Bashkë me ankesë paditësja ka bashkangjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN096-0159 të datës 26 mars 2014, një vendim të vitit 1993, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 19 janar 2012, dhe formularin e kërkesës dorëzuar të Autoriteti i Likuidimit 10 shkurt 2014.

Me 27 janar 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtën në ankesë. Në mbrojtën në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të sakte të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se ankesa e paditëses nuk i përmbush kriteret e pranushmerise nga neni 70.2 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Paditësja në ankesën e saj nuk ka saktësuar se cili neni i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e Autoriteti të Likuidimit. Tutje AKP-Ja pohon se kërkesa për paga për periudhën prill 2003 –dhjetor 2011 është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi që paditësja nuk ka ofruar dëshmi për të vërtetuar se këto paga i ka kërkuar brenda 3 viteve tek Gjykata Kompetente. Gjithashtu AKP ka theksuar se edhe vete paditësja në ankesë e pranon se gjatë periudhës 2003 deri më 2011 për të cilën kërkon kompensim nuk e ka ushtruar profesionin, pra nuk ka punuar duke ju referuar faktit se objekti i NSH –së shfrytëzohej nga Ombudspersoni. Rrjedhimisht nga ky pohim i paditëses është e qartë se kërkesa për kompensim është e pa bazuar pasi që nuk mund të kërkohej kompensim për shërbim që nuk

ka ofruar. Padiësja po ashtu nuk ka mundur të dorëzoj ndonjë provë se ka punuar në NSH nga dhjetori 2003-dhjetor 2011 pra për tetë vite me radhë. Tutja AKP shton se marrëdhënia e punës ka karakter të dyanshëm e cila karakterizohet nga puna e punëmarrësit kundrejt shpërblimit të punëdhënësit. Nga këto arsyeje AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Më 12 nëntor 2021, Shkalla e I-rë kishte lëshuar urdhër me të cilin kërkon nga ankuesja prova shtesë ne mbështetje të ankesës si dhe të caktohet vlera e kontestit.

Më 21 dhjetor 2021, ankuesja përgjigjet në urdhrin e lartcekur duke theksuar gjithsejte janë 104 paga të pa paguara edhe atë për periudhën nga prilli 2003 e deri në muajin dhjetor 2011 dhe ka specifikuar se shuma të cilën ajo e kërkon është 10,400.00 euro. Kësaj përgjigje në urdhër ajo nuk i ka bashkangjitur ndonjë provë shtesë me të cilën e bind gjykatën lidhur më kërkesën e saj.

Me 23 nëntor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykim C-IV.-14-2710, e ka refuzuar ankesën e padiësës si të pabazuar dhe ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN096-0159 të datës 26 mars 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se padiësja nuk ka sjellë prova shtesë, të kërkuara nga gjykata për të vërtetuar veçanërisht lartësinë dhe periudhën e pagave të mbetura borxh, andaj në mungesë të dëshmive, pretendimet e padiësës lidhur me të drejtën e saj në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, dhe si të tilla janë refuzuar si të pa bazuara. Shkalla e I-rë me rastin e vendosjeje është bazuar në nenin 42 pika 2 të Ligjit për DHPGJS i cili rregullon çështjen e të provuarit të palëve, përkatësisht barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimeve të tilla.

Me 23 dhjetor 2022, padiësja/ankuesja nëpërmjet përfaqësues e dorëzoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të

DHPGJS-së, C-IV-14-2710 të datës 23 nëntor 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që aprovohet ankesa si e bazuar të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar duke e anuluar të njëjtin. Në ankesën e parashtruar paditësja thekson se e kundërshton konstatimin e Shkallës së I-rë e cila refuzimin e kërkesës e ndërlidh edhe me nenin 7 të LPK-së ku rikujton se pala ka pas për obligim të paraqes të gjitha faktet mbi të cilat i mbështet kërkesat e veta. Sipas aktgjykimit ankuesja nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të dëshmuar se NSH i ka mbetur borxh pagat për periudhën e caktuar. Paditësja në ankesën e parashtruar nëpërmjet përfaqësuesit konsideron se Shkalla e I-rë nuk ka bërë vlerësim të saktë se pala nuk i ka bashkangjitur dëshmitë e saj. Paditësja thekson se kjo gjykatë nuk mund që në situata të njëjta, punëtor të njëjtë dhe me dokumente e dëshmi të njëjta, për një palë të aprovojë ankesën kurse për palën tjetër ta refuzojë. Paditësja thekson se ka dorëzuar dëshmitë siç janë: Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i të datës 19 janar 2012, lista e punëtorëve me nënshkrime dhe pagat që i kanë marrë në kesh për vitin 2000,2001,2002 dhe 2003, shuma e tyre, nënshkrimet nga të gjithë punëtorët që kanë pranuar pagat e tilla dhe konfirmimin për stazhin e punës. Paditësja po ashtu thekson se e njëjta gjykatë më 28 shtator 2022 ka nxjerrë Aktgjykim me Nr.C-IV-14-2381 tjetër ku ka aprovuar kërkesën e ankueses me dëshmi të njëjta të dorëzuara, kurse kërkesa e ankueses është refuzuar. Ky standard është i jashtëligjshëm meqë kemi të bëjmë me persona të njëjtës kategori, të njëjtës ndërmarrje, dëshmi të njëjta e veprime të njëjta më kohë nga të gjitha palët e kësaj ndërmarrje duke përfshirë edhe paditësen. Paditësja thekson se me kohë i ka kërkuar pagat e pa paguara, kërkesa është dorëzuar më 10 shkurt 2014 dhe ka qenë për 104 paga të pa paguara, nga prilli i vitit 2003 e deri në muajin dhjetor 2011. Paditësja nëpërmjet përfaqësuesit thekson se nuk ka marrë pagë nga ndërmarrja nëpërmjet bankës, janë disa lista të cilat janë dorëzuar ku ka pas ndryshime sa i përket shumave të marra kanë 250 DM, 150 DM, 100 DM, që po të marrim një mesatare do të përcaktohej si një shumë prej 100 euro pagë mujore. Andaj për 104 pagat e pa paguara për çdo muaj 100 euro, ka dal edhe shuma e cila është dorëzuar me parashtrësë më 17 dhjetor 2021. Paditësja thekson se duke u bazuar në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Ligjin e Punës, kishte që në marrëdhënie

pune deri më 19 janar 2012 dhe për këtë shkak kërkesa e saj duhet të jetë e pranueshme duke qenë se NSH ka gjeneruar të ardhura dhe kapitalin e saj.

Tutje paditësja ka theksuar se aktgjykimi i atakuar është nxjerrë në kundërshtim me nenin 9 meqë nuk përmban një prezantim të gjetjeve faktike elementet çfarë duhet të përmbajë aktgjykimi. Paditësja thekson se kemi të bëjmë edhe më çështje të shkeljeve ligjore sa i përket përfaqësimit, duke menduar se gjykatës ka në dispozicion provat të cilat i kemi bashkangjitur kërkesës së dorëzuar më 28 gusht 2014, në AKP, kjo gjykatë fare nuk ka bërë thirrje që të dorëzohen këto dëshmi dhe nuk ka treguar se i mungojnë të njëjtat, mirëpo ka marrë aktgjykim në mungesë të dëshmive, duke qenë se kemi vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelej të dispozitave ligjore për procedimin e provave.

Paditësja ankesës së parashtruar pranë Kolegjit të Apelit i ka bashkangjitur këto dëshmi: Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 19 janar 2012, lista e punëtorëve me nënshkrime dhe pagat që i kanë marr në kesh për vitin 2000,2001 dhe 2003, shuma e tyre, nënshkrimet nga të gjithë punëtorët që kanë pranuar pagat e tilla dhe konfirmimin për stazhin e punës, kërkesën e datës 28 gusht 2014, autorizimin për përfaqësim dhe aktgjykimin e atakuar.

Me 21 dhjetor 2023, AKP-ja e ka dorëzuar përgjigjen në ankesë me të cilën i ka propozuar Kolegjit të Apelit që ta refuzojë ankesën si të pa bazuar dhe ta vërtetojë aktgjykimin e atakuar. AKP-ja thekson se lidhur me argumentet e ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmërisht e sqaruar në Mbrojtjen e parashtruar si dhe në aktgjykimin me nr.C-IV.-14-2710 nga DHPGJS, pranë Shkallës së I-rë dhe përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtarë i parashtron Kolegjit të Apelit që ti referohet Mbrojtjes dhe aktgjykimit përkatës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditëses është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor, andaj duhet të vërtetohet .

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me datë 10 shkurt 2014 ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ajo ka kërkuar të paguhen pagat e pa paguara për periudhën prill 2003-dhjetor 2011 nga NSH“Marketing Export” në Prishtinë, në një shume të pa përcaktuar. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka marr Aktgjykim C-IV.-14-2710, me të cilën ka refuzuar ankesën e paditëses si të pabazuar dhe ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN096-0159 i datës 26 mars 2014, si i drejtë dhe të bazuar në Ligj dhe ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me ankesë ka bashkangjitur: vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN096-0159 të datës 26 mars 2014, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies se punës me datë 19 janar 2012 dhe formularin e kërkesës dorëzuar të Autoriteti i Likuidimit.

Bazuar në këto dëshmi, Shkalla e I-rë me të drejtë e ka refuzuar ankesën si e pabazuar dhe ka vërtetuar vendimi i autoritetit të likuidimit PRN096-0159 i datës 26 mars 2014.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja as me ankesën e saj të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit, nuk e ka bashkangjitur dëshmi me të cilat do të provohej pretendimi i saj se NSH "Marketing Exsport" asaj i ka mbetura borxh pagat e papaguara për periudhën 2003-2011. E paditura në mbrojtjen e saj ta parashtruar ndaj ankesës në Shkallë të I-rë e ka kundërshtuar kërkesën e paditëses dhe mungesën e të provuarit duke theksuar se paditësja nuk ka dorëzuar ndonjë provë se ka punuar në NSH nga dhjetori 2003-dhjetor 2011.

Kolegji i Apelit vëren se Shkallë të I-rë me 12 nëntor 2021, kishte lëshuar urdhër duke i dhen mundësi paditëses që të sjell prova në mbështetje të ankesës si dhe të caktohet vlera e kontestit. Më 21 dhjetor 2021, ankuesja përgjigjet dhe përcakton vetëm vlerën në shumen prej 10,400.00 euro, mirëpo nuk ka bashkangjitur asnjë dyshim se për periudhën prill 2003-dhjetor 2011, ka punuar në NSH dhe se NSH i ka mbetur borxh asaj, andaj me të drejtë Shkallë të I-rë kishte refuzuara si ta pabazuar ankesën e paditëses në mungesë të provave, duke zbatuar nenet 42 pika 2 të Ligjit për DHPGJS i cili rregullon çështjen e të provuarit të palëve, si dhe nenin 7 të Ligjit te procedurës Kontestimore.

Kolegji i Apelit po ashtu vëren se vet paditësja në ankesën e saj të paraqitur me 11 prill 2014 kundër vendimit të AL kishte theksuar se ajo gjatë periudhës kohore prill 2003 -dhjetor 2011 nuk ka punuar në NSH per shkak se objekti i NSH -së shfrytëzohej nga Ombudspersoni, andaj në këtë kontekst pretendimi i paditëses për pagat e papaguara në shume prej 10,400.00 euro për periudhën kohore që vet paditësja e pohon se nuk ka punuar e NSH është i pabazuar e aq me tepër siq theksuam me lartë paditësja nuk ka ofruara asnjë provë të vetme para Shkalles së I-rë se NSH i kishte mbetur borxh pagat e kërkuara. Rrjedhimisht nga ky pohim i paditëses është e qartë se kërkesa per kompensim është e pa bazuar pasi që nuk mund të kërkohet kompensim për shërbim që nuk ka ofruar.

Sa i përket pretendimit të paditëses se ajo ka në dispozicion provat të cilat i ka bashkangjitur kërkesës së dorëzuar më 28 gusht 2014, në AKP, mirëpo Shkalla e I-rë fare nuk ka bërë thirrje që të dorëzohen këto dëshmi dhe nuk ka treguar se i mungojnë të njëjtat, sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit është i pabazuar sepse siç arsyetua më lart Shkolla e I-rë me urdhrin e dt. 12 nëntor 2021, kishte kërkuara nga paditësja që të sjell prova në mbështetje të ankesës, mirëpo e njëjta nuk kishte bashkangjitur asnjë provë.

Kolegji i Apelit i ka shqyrtuara dhe vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të paditëses, mirëpo nuk ka gjetura se ka shkelje, dhe gjithashtu nuk mund të pajtohet me pretendimet e paditëses se kërkesa e saj për paga për periudhën e lartcekur është bazuar, pasi që të njëjtat nuk janë të argumentuara dhe nuk janë të mbështetura me prova.

Kolegji i Apelit gjithashtu konstaton se provat e bashkangjitura me ankesë në Kolegjin e Apelit nuk janë relevante dhe si të tilla nuk do të mund të ndikonin që Kolegji Apelit ta ndryshojë Aktgjykimin e atakuar.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 16 janar 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 04 prill 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_